



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/91
Datë: 08.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 8 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Përkitazi me Themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/91
Datë: 08.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 8 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes financiare për IPA 2016 për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.
2. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian që të ndërmarrë të gjitha hapat në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/91

Datë: 08.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Rrugët nr. 2003/11, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 8 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Rruga Nacionale N25.3, segmenti Gjilan-Ferizaj emërohet "BEAU BIDEN".
2. Vendimi merret në bazë të vlerësimit të organeve më të larta të Republikës së Kosovës për rolin dhe kontributin e veçantë të BEAU BIDEN në ndërtimin e institucioneve të Republikës së Kosovës, si dhe propozimit të Ministrisë së Infrastrukturës, Komunës së Gjilanit dhe Ferizajt.
3. Rruga Nacionale N25.3, segmenti Gjilan-Ferizaj është arteria kryesore e cila lidhë këto dy komuna të Republikës së Kosovës, përgjatë së cilës është e vendosur baza kryesore e Ushtrisë së SHBA në Kosovë, Bondsteel.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/91

Datë: 08.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8, 44 dhe të nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 8 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit për ndërtimin e "Ngrohtorja e Re e Qytetit në Gjakovë", Zona Kadastrale Gjakovë, Komuna Gjakovë, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, ta cilat tabela paraqesin pjesët përbërëse të këtij vendimi.
2. Vlerësimi i pronave do të kryhet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në Ministrinë e Financave, në përputhje me aktet nënligjore të miratuara në pajtim me paragrafin 6. të nenit 15 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit(MMPH), Ministria e Financave dhe Komuna e Gjakovës.
4. Mjetet financiare për kompensimin e shpronësimit të pronave të paluajtshme, shpenzimet e procedurës së shpronësimit dhe vlerësimit do të sigurohen nga Komuna e Gjakovës.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/91

Datë: 08.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 8 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i ndërtesave të përhershme të menaxhimit të integruar te kufirit IBM mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë: Pikat Kufitare Bërnjak, Zona Kadastrale Banjë, Komuna Zubin Potok dhe Merdar Zona Kadastrale Merdar, Komuna Podujevë, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesët përbërëse të këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi, apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Brendshme.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/91

Datë: 08.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 8 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës R6 Prishtinë-Hani i Elezit, sektori C2C dhe C3, Zonat Kadastrale: Kaçanik i Vjetër, Koxhaj, Soponicë, Doganaj, Rekë, Nikaj, Biqec, Kovaçec, Bob, Gajre, Kaçanik dhe Gjurgjedell të Komunës së Kaçanikut, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesët përbërëse të këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen, dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Financave.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/91

Datë: 08.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 8 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen Konkluzionet e dala nga takimi i VIII-të i Këshillit të Ministrave për Reformën e Administratës Publike.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, obligohen Institucionet të cilat kanë obligime nga Konkluzionet sipas pikës 1. të këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/91

Datë: 08.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, si dhe në pajtim me Vendimin e Këshillit për Pozitat e Nivelit të Lartë Drejtuese, nr.04/2016, në mbledhjen e mbajtur më 8 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Driton Gashi, i vazhdohet mandati i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme edhe për tre (3) vjet.
2. Z. Gashi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/91

Datë: 08.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, sipas Propozimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. prot. 1786, datë 31.05.2016, në mbledhjen e mbajtur më 8 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 12/82 të datës 30.03.2016

1. Ndryshohet pika 1 e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 12/82 të datës 30.03.2016, si në vijim: pas fjalës "euro", fshihet shprehja: "për stafin administrativ të".
2. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/91

Datë: 08.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 8 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Grupit Ndërministror për hartimin e Strategjisë nacionale për mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë (dhe planin e veprimit) për:
 - 1.1. Përmbushjen e obligimeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës që dalin nga Rezoluta 1540 e OKB-së;
 - 1.2. Krijimi i kapaciteteve institucionale për luftimin e kërcënimeve specifike të C-WMD-së;
 - 1.3. Të promovojë reformën e sektorit të sigurisë dhe përkrah bashkëpunimin dhe koordinimin regional kundër kërcënimeve të përbashkëta;
 - 1.4. Si pjesëmarrëse në kuadër të Qendrës për Bashkëpunim të Sigurisë RACVIAC - zbatimi i "hartës së rrugës" (roadmap) të dakorduar për krijimin e strategjive nacionale kundër C-WMD;
 - 1.5. Të përkrah proceset integruese rajonale, evropiane dhe euro-atlantike.

2. Grupi Ndërministror ka këtë përbërje:
 - 2.1. Lulzim Mjeku - Drejtor i Departamentit për Politikën e Sigurisë dhe NATO/MPJ Kryesues;
 - 2.2. Berat Jashari - Zyrtar i Lartë i Politikave të Sigurisë- MPJ, anëtar;
 - 2.3. Avni Hasani - Zyrtar i Lartë për Traktate / MPJ, anëtar;
 - 2.4. Bujar Haxhidauti - Drejtor i Terminalit Doganor në PR, anëtar;
 - 2.5. Major Fadil Zullufi - Oficer për Plane dhe Operacione /MFSK, anëtar;
 - 2.6. Arton Muçaj - Udhëheqës i Divizionit për mallra ushtarake, transit dhe broker/MTI - anëtar;
 - 2.7. Mensur Hoti - Drejtor i Sigurisë Publike/MPB, anëtar;
 - 2.8. Major Fehmi Xhata - Drejtor, PK, anëtar;
 - 2.9. Kapiten Vllaznim Surdulli -U.D, Drejtor i Drejtorisë për Planifikim dhe Vlerësim Operacional/PK, anëtar;
 - 2.10. Bekim Podrimqaku - Drejtor i Departamentit për Analizë dhe Politika të Sigurisë/KSK - anëtar;
 - 2.11. Beqir Mezelxhiu - Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore (AKMRrSB) - anëtar.

3. Obligohen të gjitha Ministritë e linjës ta ndihmojnë dhe përkrahin Grupin Punues për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi, për hartimin e Strategjisë të shprehur si në pikën 1 të këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/91

Datë: 08.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 8 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Produktet e Ndërtimit.
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/91

Datë: 08.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 8 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Pajisjet nën Presion të cilat i nënshtrohen presionit punues më të madh se 0.5 Bar Manometrik.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/91

Datë: 08.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 8 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 190,000 (njëqind e nëntëdhjetë mijë euro) për pagesën e kontributit në Fondin e Inovacionit të Mekanizmit të Zhvillimit të Ndërmarrësisë dhe Inovacionit të Ballkanit Perëndimor (WB EDIF).
2. Mjetet nga pika 1 e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria ekonomike e Rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, kodi organizativ 204, nën-programi Agjencia për Zhvillim dhe Promovim të Sektorit Privat, me kod 49000, kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Isa Mustafa
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/91
Datë: 08.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 8 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Këshillit Koordinues të Asociacioneve Familjare të të Zhdukurve të Kosovës për përkrahjen financiare në shumë prej 7,000 euro, për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve të rregullta vjetore me rastin e shënimeve të ditëve të veçanta për persona të zhdukur.
2. Mjetet nga pika 1 e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria ekonomike e Rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Financave në nën-programin e Thesarit me kod 11200 në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere.
3. Mjetet nga pika 2. e këtij vendi transferohen në xhironlogarinë e Këshillit Koordinues të Asociacioneve Familjare të të Zhdukurve të Kosovës, numër 1503001002032142 në Bankën Komerciale Raiffeisen.
4. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/91

Datë: 08.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke iu referuar kërkesës me nr. protokolli 1381, në mbledhjen e mbajtur më 8 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë 20,000 (njëzetmijë euro) për përkrahjen e projektit për ndërtimin e trotuarit dhe ndriçimit publik, asfaltimin e rrugës në fshatin Burkovë, si dhe asfaltimin e rrugës për në Manastirin Ortodoks në Budisalc.
2. Mjetet financiare nga paragrafi 1. i këtij vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës për Çështje të Komuniteteve, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, dhe destinohen për financimin e projektit të Komunës së Klinës.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/91

Datë: 08.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 8 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë 20,000 (njëzetmijë euro) në bazë të Kërkesës së OJQ "Durmish Asllano" me nr. protokolli 916, të datës 22.03.2016.
2. Mjetet financiare nga paragrafi 1 i këtij vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës për Çështje të Komuniteteve, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, kodi buxhetor 15600, kategoria subvencione dhe transfere, dhe do të shfrytëzohen për manifestimin e Ditës Ndërkombëtare Rome.
3. Mjetet financiare nga paragrafi 1 i këtij vendimi paguhen në llogarinë e OJQ "Durmish Asllano" Banka Ekonomike, me numër të llogarisë: 1404000003850444.
4. Përfituesi brenda dy muajve është i obliguar të raportoj dhe ofroj dëshmi (kupon fiskal dhe dëshmi tjera) në Zyrën për Çështje të Komuniteteve për realizimin e këtij projekti.
5. Obligohet Zyra për Buxhet dhe Financa/ZKM për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë